




KUVENDI

Revistë e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 40 korrik 2013



Përmbajtja

Delegacion i Kuvendit të Kosovës në Jordani	3
BE - “Mirë se vjen” CROACI	6
Miratohet Projekt - ligji për Amnistinë	11
Mbyllet sesioni pranveror	13
Nga Puna e Komisioneve	14
Dëgjimi publik	18
Nga aktivitetet e GGD-ës	21
Tryezë	23
Diplomacia Parlamentare	27



Harta fizike e vendeve që kanë njohur pavarësin e Kosovës

Delegacion i Kuvendit të Kosovës në Jordani



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, i shoqëruar nga deputetët Ahmet Isufi dhe Amir Ahmeti, realizuan një vizitë zyrtare në Jordani.

Kreu i Kuvendit të Kosovës është pritur në Aeroportin e Amanit nga homologu i tij, Saed Hayel Srour, kryetar i Dhomës së Përfaqësuesve të Parlamentit të Jordanisë.

Saed Hayel Srour shprehu kënaqësinë për vizitën e delegacionit parlamentar nga Kosova, për të arriturat e saj dhe njohjen ndërkombëtare të pavarësisë. Duke shprehur dëshirën dhe gatishmërinë për thellimin e marrëdhënieve midis dy vendeve, në veçanti midis dy parlamenteve, Srour e konsideroi këtë vizitë një

mundësi të mirë për tu njohur me zhvillimet në të dyja vendet dhe për të thelluar bashkëpunimin e ndërsjelltë. Ai shtroi nevojën që në të ardhmen, deputetët e të dy parlamenteve, të shkëmbejnë përvoja parlamentare. Në këtë funksion, ai shprehu dëshirën dhe gatishmërinë për të formuar grupin e miqësisë me Kuvendin e Kosovës, hap ky që u mirëprit dhe u përkrah plotësisht nga kryetari Krasniqi. Kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve të Parlamentit jordanëz siguroi se Jordania do të vazhdojë të ushtrojë ndikimin e saj të vendet islamike, për ta njohur Republikën e Kosovës.



Kryeparlamentari Krasniqi falenderoi homologun e tij për pritjen e ngrohtë e miqësore dhe shprehu kënaqësinë për vizitën që po i bën Jordanisë, për njohjen e Republikës së Kosovës dhe për mbështetjen e vazhdueshme në institucionet ndërkombëtare. Ai shprehu edhe njëherë gjithë mirënjohjen e vendit dhe

popullit tonë për miqësinë e sinqertë dhe për mbështetjen e pakursyer që Jordania i ka dhënë dhe po i jep Kosovës. Presim që Jordania të vazhdojë mbështetjen për njohjen e Kosovës edhe te vendet e tjera arabe e islamike që ende nuk e kanë bërë këtë", theksoi kryetari Krasniqi.

"Republika e Kosovës dëshiron të thellojë marrëdhëniet me Jordaninë në të gjitha fushat, si partnerë strategjikë, në dobi të interesave e të bashkëpunimit reciprok dhe të miqësisë midis dy vendeve dhe popujve tanë.

Më tej e njoftoi homologin e tij jordanëz me zhvillimet aktuale në vendin tonë, duke theksuar se Kosova ka arritur zhvillim të rëndësishëm në procesin e fuqizimit të pozitës së saj ndërkombëtare, njohjen e pavarësisë nga shumica e vendeve anëtare të OKB-së, synimet perspektive drejt integriteteve evropiane, anëtarësimin

e saj në familjen e madhe të Kombeve të Bashkuara dhe në organizata të tjera ndërkombëtare. Kreu i legjislativit, pas paraqitjes të punës dhe përbërjes së Kuvendit, si dhe aktiviteteve të ndryshme parlamentare i bëri ftesë zyrtare homologut të tij jordanëz për një vizitë në Kosovë.

Delegacioni parlamentar i Kosovës u takua me kryeministrin jordanez, Abdullah Ensour dhe me kryetarin e Senatit, Taher N. Masri



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi në ditën e dytë të vizitës zyrtare në Mbretërinë Hashemite të Jordanisë, u prit në takime të ndara nga kryeministri i Jordanisë, Abdullah Ensour dhe kryetari i Senatit të Parlamentit të Jordanisë, Taher N. Masri.

Duke shprehur dëshirën dhe gatishmërinë për thellimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit midis dy vendeve, udhëheqësit jordanezë siguruan kryetarin e Kuvendit të Kosovës se Jordania do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën në të gjitha fushat.

Kryeministri jordanez, Abdullah Ensour, theksoi se vizita delegacionit nga Kosova është mundësi e mirë e njohjes nga afër me zhvillimet politike dhe ekonomike në të dy vendet dhe shtroi nevojën që në të ardhmen të shkëmbehen edhe më shumë vizita zyrtare. Ai tha se ekzistojnë mundësi të shumta të bashkëpunimit në fusha të ndryshme.

“Të gjithë ne jemi krenarë që e kemi njohur Republikën e Kosovës qysh në vitin 2009, prandaj gëzohem që ekziston një shkëmbim politik, por edhe kulturor midis dy vendeve tona”, theksoi ndër të tjera kryeministri jordanez.



Kryeparlamentari Krasniqi priti presidentin e Këshillit Evropian, Herman Van Rompuy

Krasniqi falënderoi z. Rompuy për vendimin e KE-së për hapjen e negociatave me Kosovën për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit Presidenti i Këshillit Evropian premtoi vazhdimin e mbështetjes së Bashkimit Evropian për Kosovën



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, ka pritur sot në takim presidentin e Këshillit Evropian, Herman Van Rompuy, me të cilin ka biseduar zhvillimet aktuale në Kosovë, vendimin e Këshillit të Evropës (KE) për hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Kosovën (MSA), ndihmën e Bashkimit Evropian (BE) për Kosovën, zgjedhjet e ardhshme etj.

Duke i uruar z. Rompuy mirëseardhje në Kosovë dhe në Kuvendin e saj, kryetari Krasniqi shprehu falënderimet për të gjithë ndihmën që Bashkimi Evropian i ka dhënë dhe po i jep Kosovës, dhe në mënyrë të veçantë, për vendimin e KE-së për hapjen e negociatave për MSA-në.

“Ky vendim është një dritare e madhe për Kosovën, e cila hapë perspektiva për liberalizimin e vizave për qytetarët dhe integrimin evropian të saj”, theksoi kryeparlamentari Krasniqi, duke shtuar se rruga evropiane e Kosovës nuk ka alternativë.

Duke e konsideruar këtë një lajm të mirë për Kosovën, z. Rompuy falënderoi Kuvendin e Kosovës për ratifikimin e marrëveshjes me Serbinë dhe ofroi mbështetjen e Bashkimit

Evropian për zbatimin e saj.

Kryetari Krasniqi, ndërkaq, shtroi nevojën e një ndikimi pozitiv mbi Serbinë nga ana e BE-së, për të realizuar të gjitha marrëveshjet e arritura në Bruksel, ndërsa shfaqti interesimin e institucioneve të Kosovës për normalizimin e marrëdhënieve në të mirë të të dyja vendeve dhe të rajonit në përgjithësi.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës u ndal edhe në sfidat me të cilat përballen Kosova dhe qytetarët e saj, duke veçuar hapjen e vendeve të reja të punës, zhvillimin ekonomik dhe sundimin e rendit e të ligjit. Në këtë drejtim, kryetari Krasniqi kërkoi vazhdimin e ndihmës nga ana e Bashkimit Evropian.

Herman van Rompuy, ndërkaq, premtoi vazhdimin e mbështetjes financiare për Kosovën dhe agjendën ekonomike të saj.

Në takim i bisedua edhe për zgjedhjet e ardhshme lokale dhe parlamentare në Kosovë. Të dy bashkëbiseduesit u pajtuan se mbajtja e zgjedhjeve të jenë të lira e të drejta, ka rëndësi vitale për reputacionin e Kosovës.

BE - “Mirë se vjen” CROACI



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi e ka uruar kryetarin e Parlamentit të Republikës së Kroacisë, z. Josip Leko, me rastin e hyrjes së Republikës së Kroacisë në Bashkimin Evropian. Në telegramin e urimit të kryeparlamentarit Krasniqi thuhet:

I nderuar zoti Kryetar,

Në emër të deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe në ermin tim personal, me rastin e hyrjes së Republikës së Kroacisë në Bashkimin Evropian, kam kënaqësinë dhe nderin e madh t'ju shpreh urimet më të përzemërta dhe më të sinqerta ju dhe tërë popullit të Republikës së Kroacisë.

Kjo ditë e shënuar për Kroacinë, më jep rastin, t'ju siguroj për angazhimin tim dhe të Kuvendit të Kosovës për të vazhduar thellimin e mëtejshëm të marrëdhënieve tona të shkëlqyera dhe të partneritetit strategjik midis shteteve tona, nëpërmjet bashkëpunimit të frytshëm në të gjitha fushat me interes të përbashkët. Ju lutem zoti Kryetar, pranoni shprehjen e konsideratës sime më të lartë për Ju dhe për popullin e Kroacisë

Seancë solemne

Ne ndajmë një vizion me Kosovën, të qenit pjesë e Evropës.

Me rastin e vizitës në Kosovë të Komisionarit të Komisionit Evropian për Zgjerim dhe Politika të Fqinjësisë, z. Stefan Fyle, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka mbajtur një seancë solemne, në të cilën komisionari evropian ka mbajtur një fjalë rasti.



ryetari i Kuvendit, dr. Jakup Krasniqi, i cili i uruoi z. Fyle mirëseardhjen në Kosovë dhe në Kuvendin e saj, tha se ardhja e tij kësaj radhe ka një sebep të madh dhe ogur të bardhë. Kosova, shtoi Krasniqi, më në fund po hyn në procesin e marrëdhënieve kontraktuale me

Bashkimin Evropian, ndërsa shfaqti shpresën që të nisin dhe të përmbyllen shumë shpejt negociatat midis Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit.



"Jemi të bindur që Bashkimi Evropian dhe të gjithë mekanizmat e institucionet e tij, do ta mbështesin fuqishëm vendin tonë në këtë proces historik, sepse Kosova e re ka kaq shumë nevojë për paqe e siguri të qëndrueshme, stabilitet e zhvillim demokratik, reformim të gjithanshëm dhe ngritje të fuqishme ekonomike, për drejtësi, sundim të ligjit e mirëqenie sociale dhe së fundi, për t'u ndjerë e barabartë dhe dinjitoze midis vendeve të lira dhe demokratike".

Kuvendi i Kosovës po jep kontribut të pazëvendësueshëm në proceset integruese evropiane të Kosovës, sidomos në fushën e legjislacionit dhe të zbatimit të planeve të tij të veprimit, konform rekomandimeve të raporteve të progresit të Komisionit

Evropian. "Veprimtaria e fundit e Kuvendit tonë në drejtim të integritimit dhe të liberalizimit të vizave ishte vetëm pak orë më parë në këtë sallë, kur shqyrtuam një varg ligjesh që kanë të bëjnë me këtë proces", theksoi ndër të tjera kryetari Krasniqi.

Fjala e Komisionarit të Komisionit Evropian për Zgjerim dhe Politika të Fqinjësisë, z. Stefan Fyle, para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës

"Z. kryetar,
Anëtarë të nderuar të Kuvendit,
Zonja dhe zotërinj,

Ju faleminderit shumë për ftesën tuaj sot.

Në mars të vitit të kaluar unë pata privilegjin dhe mundësinë që t'u adresohem disa prej jush. Mirëpo në atë kohë, ne kishim një agjendë ambicioze, të vendosur nga Këshilli i dhjetorit, dhe po shikonim para drejt vendimeve të rëndësishme për ta realizuar këtë ambicie. Sot, rreth katër muaj pas, unë kam kënaqësinë që jam në gjendje të konfirmoj se ne kemi paraqitur një agjendë evropiane ambicioze së bashku, Kosova dhe Bashkimi Evropian. Kemi pasur një ndryshim sizmik në raportet tona vetëm brenda

disa muajve. Kosova ka realizuar një "marrëveshje të parë parimore" me Serbinë dhe është pajtuar për harmonizimin e planit të implementimit. Dhe Bashkimi Evropian është pajtuar që të nisë negociatat për një Marrëveshje Stabilizim Asociimi me Kosovën.

Këto zhvillime meritojnë një reflektim, të ndalemi për të menduar para se të lëvizim tutje së bashku.

Pra, si ka ardhur e gjithë kjo? Çfarë e ka mundësuar këtë? Janë tre faktorë që më vijnë ndër mend menjëherë: Vizioni; Kreativiteti dhe Kuraja.



Ne ndajmë një vizion me Kosovën, të qenit pjesë e Evropës.

Ky është një vizion gjithëpërfshirës. Një vizion i Kosovës për të qenë një vend: - Ku të gjithë qytetarët e saj jetojnë së bashku në harmoni, pa marrë parasysh etninë e tyre; - Ku të gjitha pozitat e shoqërisë përfaqësohen për pjesëmarrje në një debat të hapur për prioritetet dhe drejtimin e Kosovës, pa varësisht nga animi politik dhe ku protestat e dhunshme dhe kërcënimi i takojnë së kaluarës; - Ku - si rezultat - të gjithë qytetarët janë të motivuar për të kontribuar në mënyrë konstruktive në ndërtimin e një shteti që i ka drejtuar sytë drejt së ardhmes dhe i cili ndjehet i qetë me fqinjët e tij. Një vend i ndërtuar mbi parimet demokratike të kontrolleve dhe bilanceve të të tri pushteteve - ekzekutivit, legjislativit dhe gjyqësorit.

Ne ndajmë një vizion me Kosovën, që është pjesë e një rajoni gjithëpërfshirës.

Një vizion i Kosovës që ndan të njëjtat perspektiva si fqinjët e saj, duke punuar shumë për të tejkaluar sfidat e ngjashme dhe e cila dëshiron të jetë pjesë e zgjidhjeve të njëjta. Mbi të gjitha, ky është një vizion i Kosovës që ndan të njëjtin fat sikurse fqinjët e saj. Ky është vizioni ka udhëhequr punën tonë së bashku. Kosova ka luajtur rolin e saj përmes implementimit të agjendës së reformave të Bashkimit Evropian, - adresimit të prioritetëve të identifikuar në studimin tonë të fizibilitetit; - Arritjes së progresit konkret dhe të qëndrueshëm jo vetëm në sundimin e ligjit, administratës publike dhe mbrojtjes së minoriteteve, mirëpo edhe në tregti, dhe përmes përmirësimit të raporteve të saj me fqinjët; - Angazhimit konstruktiv në një dialog me

Serbinë në kuadër të kornizës së perspektivës evropiane të të dyja vendeve.

Ne e ndajmë këtë vizion duke mbështetur Kosovën aty ku mundemi përmes asistencës financiare dhe teknike dhe me këshilla, me anë të mobilizimit të të gjitha mjeteve tona për zgjerim, përfshirë këtu Dialogun e Strukturuar për Sundimin e Ligjit dhe Dialogun për Procesin e Stabilizim Asociimit.

Faktori i dytë që kam identifikuar ishte kreativiteti.

Të nderuar anëtarë të parlamentit, Pa kreativitet, Kosova nuk do të kishte gjetur mënyra për t'u dakorduar me Serbinë për çështje të vështira të cilat mbulohen nga "Marrëveshja e parë parimore" historike e 19 prillit, si:

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rajonal i Kosovës; dhe MIK (IBM).

Pa kreativitet, ne nuk do t'u kishim propozuar shteteve tona anëtare një Marrëveshje Stabilizim Asociimi me Kosovën në fund të vitit të kaluar. Dhe ne nuk do të kishim gjetur mënyra për të marrë një autorizim nga Këshilli për të punuar me ju në një marrëveshje Stabilizim Asociimi të fortë, e cila përfshin dispozitat për tregti, treg të brendshëm, drejtësi dhe çështje të brendshme, politike të huaj dhe të sigurisë dhe një sërë politikash të gjera bashkëpunimi.

I fundit nga këta faktorë është kuraja

Zonja dhe zotërinj,

Pa kurajë, lidhshipi i Kosovës nuk do të ishte angazhuar në dialogun e nivelit të lartë me Serbinë në tetorin e vitit të kaluar, nuk do të ishte në gjendje që të gjente kompromise që shpien drejt Marrëveshjes së parë historike të prillit. Nuk do të ishte arritur dakordim në maj për planin e implementimit. Dhe nuk do të ishte propozuar për ratifikim marrëveshja e prillit nga ky Kuvend, për t'u aprovuar nga dy të tretat shumicë disa javë më parë.

Dhe nga ana jonë, BE-ja pati kurajën që të vjen me një mandat për një marrëveshje Stabilizim Asociimi me Kosovën, derisa shtetet tona anëtare kanë pozita të ndryshme mbi statusin e Kosovës dhe disa kanë edhe çështje serioze lidhur me kompetencat e Bashkimit Evropian dhe shteteve anëtare.

Prandaj, ne do të vazhdojmë të punojmë së bashku, të udhëhequr nga vizioni ynë, duke përdorur kreativitetin tonë dhe kurajën tonë për të adresuar sfidat me të cilat ballafaqohemi.

Neve na duhet që ju të vazhdoni me implementimin e marrëveshjeve të Dialogut me Serbinë dhe të punoni për marrëveshjet e reja, për të negociuar një Marrëveshje Stabilizim Asociimi dhe ta implementoni atë, dhe ta bëni Kosovën një vend më të mirë për të jetuar për të

gjithë qytetarët e saj, duke e shpjerë përpara agjendën e reformave. Dhe ne duhet të punojmë drejt momentit kur të gjitha vendet në rajon do të jenë të gatshme t'i bashkohen Bashkimit Evropian.

Ju, Kuvendi i Kosovës, luani rolin kryesor në këtë mes. Ju duhet të tregoni vizion, kreativitet dhe kurajë për të miratuar legjislacionin kryesor, në mënyrë që të siguronit se zgjedhjet i plotësojnë standardet evropiane. Qytetarët e Kosovës presin prej jush që ta kryeni detyrën tuaj pa vonesë.

Ju gjithashtu duhet të keni vizion dhe kurajë për të miratuar legjislacionin që mundëson funksionimin e marrëveshjes së prillit. Kjo nënkupton aprovimin nga ana juaj të legjislacionit dhe proceseve të vështira, si ai i Ligjit për Amnisti që ndodhi javën e kaluar, dhe të dakordoheni për legjislacionin e ardhshëm lidhur me vetë-qeverisje lokale dhe të drejta të komuniteteve.

Ju duhet t'i merrni këto vendime të vështira dhe nganjëherë të dhimbshme që Kosova të jetë në gjendje të kthejë faqen dhe të bëhet anëtare paqësore dhe e suksesshme e familjes sonë evropiane. Ju duhet të mbani llogaridhënie ekzekutive: të debatonit për ligjet dhe politikën, të monitoroni implementimin e tyre dhe të kërkonit vendimet e ministrave. Në të njëjtën kohë, ju do të krijoni kushte dhe një mjedis në të cilin gjyqësori e bën punën e tij për sundim të ligjit, i papenguar dhe pa presion politik. Ju gjithashtu duhet të finalizoni aprovimin e legjislacionit që ka të bëjë me dialogun për liberalizimin e vizave, në të cilin ka punuar qeveria bashkë me ne që nga miratimi i raportit për viza në muajin shkurt.

Kur është fjala për integrimin evropian, EULEX-i është gjithashtu një instrument i veçantë i krijuar për t'i ndihmuar Kosovës në arritjen e standardeve evropiane në Sundimin e Ligjit. EULEX-i, përfshirë gjykatësit dhe prokurorët e tij, vepron si një pjesë integrale e institucioneve të Kosovës dhe zbaton ligjin e Kosovës. Ju duhet që në mënyrë aktive ta mbështesni EULEX-in në implementimin e mandatit të tij, ashtu siç është bërë e qartë në Studimin e Fizibilitetit të viti të fundit. EULEX-i është një mbështetje për të mirën e Kosovës; një mbështetje prej së cilës nuk mund të përfitojnë vendet e tjera në rajon. Ai është edhe një mbështetje e nevojshme në fushat kryesore ku ka mungesë të qartë të kapacitetit lokal.

Sundimi i ligjit do të vazhdojë të mbetet një temë kryesore e Kosovës, ashtu siç do të jetë edhe për pjesën tjetër të rajonit. Bashkimi Evropian do të vazhdojë t'i ndihmojë Kosovës në përpjekjet e saj për të fuqizuar sundimin e ligjit. Me lëvizjen para të Kosovës, edhe Bashkimi Evropian lëviz para. Ne do të përshtatim partneritetin tonë me ju sipas progresit që ju arrini. Komisioni është i gatshëm që të rrisë përfshirjen e tij në raportin e BE-së me Kosovën, përfshirë këtu sundimin e ligjit. Duke e bërë këtë, natyra e mbështetjes së tij do të ndryshojë.

Z. kryetar, të nderuar anëtarë të Kuvendit, zonja dhe zotërinj,



Më lejoni që t'i përmbledh sfidat e periudhës që kemi përpara:

Propozoj që t'i bashkojmë forcat dhe të nisim negociatat për një marrëveshje Stabilizim Asociimi pas kësaj vere, në bashkëpunim të ngushtë me vendet tona anëtare. Propozoj që t'i caktojmë negociatorët tonë përkatës. Propozoj që të organizojmë punën ashtu që sesionet zyrtare të negociatave t'i mbajmë në tetor, nëntor dhe në shkurt të vitit të ardhshëm. Propozoj që të krijojmë grupe punuese teknike të përbashkëta për t'i përgatitur këto sesione. Dhe në bashkëpunim të ngushtë me shtetet anëtare, propozoj që t'i vëmë vetes caqe ambicioze që ta përmbledhim punën tonë në pranverë.

Paralelisht, Kosova do të duhet të vazhdojë me punën e mirë që ka bërë në përgatitjen e Këshillit të qershorit. Kosova duhet të vazhdojë punën e saj në prioritetet e studimit të fizibilitetit. Do të duhet të vazhdojë të punojë në raportet e saj me Serbinë. Nga ana jonë, ne do të vazhdojmë të mobilizojmë dhe të fuqizojmë më tej mjetet që kemi në dispozicionin tonë për t'ju ndihmuar. Përmes Dialogut të Strukturuar për Sundimin e Ligjit, ne do t'ju ndihmojmë që të fokusoheni në prioritetet përtej vitit 2014 dhe për të ardhmen, dhe të pajtoheni për veprim të synuar për arritjen e objektivave të përbashkëta. Ne do të aprovojme të gjitha instrumentet tona për të

qenë në gjendje që t'ju ndihmojmë më mirë. Ne do ta fuqizojmë partneritetin tonë.

Komisioni Evropian është bërë një partner më i rëndësishëm për ju sa kurrë ndonjëherë. Kosova tani është vendosur fuqishëm në rrjedhën e zgjerimit. Duke negociuar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, Komisioni është angazhuar me Kosovën më shumë se kurrë më parë. Ne jemi zotuar fuqishëm që t'ju ndihmojmë të bëheni pjesë e rrugës për tërë rajonin e Ballkanit perëndimor, për të qenë pjesë integrale e Bashkimit Evropian, duke mos lënë prapa ambicien dhe progresin e të tjerëve.

Pres me padurim punën tonë të mëtutjeshme së bashku, si partnerë që mund t'i besojmë dhe mund të mbështeten në njëri-tjetrin. Ne besojmë dhe mbështetemi në rezultatet e Kosovës për përmirësimin e raporteve të saj me Serbinë dhe në vazhdimin me agjendën e saj të reformave të Bashkimit Evropian. Dhe Kosova mund të na besojë dhe të mbështetet tek Bashkimi Evropian për mbajtjen e premtimit të saj dhe nënshkrimit dhe realizimit të një Marrëveshje Stabilizim Asociimi dhe ndërtim të mëtejshëm të raporteve tona, për të siguruar se Kosova mund ta ketë vendin e saj që i takon në Evropë.

Ju faleminderit për vëmendjen tuaj".

Miratohet Projekt - ligji për Amnistinë

Kuvendi i Republikës së Kosovës,
në mbledhjen e datës 11.07.2013 plenare, të drejtuar nga dr. Jakup Krasniqi,
kryetar i Kuvendit (një pjesë të saj e ka kryesuar nënkryetari, Xhavit Haliti),
ka shqyrtuar për herë të parë Projektligjin për amnistinë.

Fillimisht kryeparlamentari Krasniqi ka kërkuar nga deputetët që të votojnë për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, pasi që projektligji në fjalë nuk ka plotësuar kushtet ligjore për shqyrtim (dy javë kohë për shqyrtim nëpër komisione). Deputetët me shumicë votash kanë votuar për shmangien nga Rregullorja .

Projektligjin për amnistinë e ka arsyetuar para deputetëve zv.kryeministri dhe ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi, i cili është shprehur se e mban të njëjtin

qëndrim, sikurse në seancën e shkuar kur e pati arsyetuar projektligjin me të njëjtin emër, i cili nuk pati marrë numrin e mjaftueshëm të votave. Duke pohuar se kyprojektligj përmban parimet kryesore për të qenë i mirë: është në përputhje me interesat e qytetarëve; i përmbush standardet ndërkombëtare dhe, siç është shprehur ai, popullit i bie tamam, ka kërkuar nga deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.



Kryetari i Komisionit për Legjislacion, Arben Gashi, ka kërkuar gjithashtu që të miratohet ky projektligj.

"Vullneti i përgjithshëm i Partisë demokratike të Kosovës dhe i grupit të saj parlamentar është që ta përkrahim këtë projektligj, i cili shpartallon strukturat ilegale , siguron integritetin territorial të vendit dhe integron qytetarët", është shprehur Behar Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

Duke u shprehur i kënaqur se në ndryshimet e projektligjit janë marrë parasysh kërkesat e Grupit Parlamentar të LDK-së: mos amnistimi i veprave penale kundër jetës dhe trupit , si dhe mospërfshirja në amnisti e pasurimit të paligjshëm të qeveritarëve dhe i familjarëve të tyre, Haki Demolli ka theksuar se deputetët e LDK-së e mbështesin këtë projektligj.

Deputetja e Vetëvendosjes!, Albulena Haxhiu, ka theksuar se asnjërin nga kushtet që i atribuohen nga zv.kryeministri Kuçi, nuk i plotëson Projektligji për Amnistinë: " Ai është në kundërshtim të interesit të qytetarëve; është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe popullit nuk i bie tamam", është shpreh deputetja, duke theksuar se qëllimi i projektligjit është

amnistimi i krimeve në veri dhe i krimit të organizuar në Kosovë.

Duke e ripërsëritur edhe në këtë seancë se Grupi Parlamentar i AAK-së e mbështet miratimin e këtij projektligji, Ardian Gjini, ka tërhequr vëmendjen se amnistinë nuk po e bën Serbia, por po e bën Kosova për një pjesë të qytetarëve të saj.



Duke i dhënë mbështetje projektligjit në emër të Grupit Parlamentar të KKR-së, Myzejene Selmani, ka shprehur kënaqësinë e saj për heqjen nga projektligji të nenit 3.

Petar Miletiç, në emër të Grupit Parlamentar (SLS) e ka mbështetur miratimin e këtij projektligji, duke e vlerësuar atë si kusht për përfundimin edhe juridik të konfliktit dhe të eliminimit të frikës së qytetarëve të pjesë veriore për hakmarrje voluntariste nga pjesëtarët e popullsisë shumicë në Kosovë.

Mbështetje projektligjit i ka dhënë edhe Goran Marinković (ZB).

Në vazhdim të seancës ka pasur diskutime të shumta për projektligjin për amnistinë. Derisa shumica e deputetëve të grupeve parlamentare që i kanë dhënë

mbështetje këtij projektligji, kanë mbajtur qëndrime të ngjashme me shefat e grupeve të tyre parlamentare, deputetët e Vetëvendosjes! an-blok kanë qenë kundër miratimit të projektligjit. Kështu, nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, nga ky subjekt, Glauk Konjufca, e ka quajtur amnistinë si pakt ndërmjet shtetit dhe qytetarit, në periudhat pas konfliktit. Ligjit për amnistinë të sponsorizuar nga ekzekutivi i vendit e ka quajtur kontratë të Qeverisë së Kosovës me Beogradin dhe jo me popullin e Kosovës.

Në përfundim të debatit deputetët me shumicë votash (91 "për" dhe 17 "kundër") e kanë miratuar në parim Projektligjin për amnistinë, duke e autorizuar Komisionin për Legjislacion që sa më parë ta shqyrtojë projektligjin në fjalë dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Mbyllet sesioni pranveror

Me zhvillimin e seancës së dt.31.07.2013
Kuvendi i Kosovës mbylli edhe sesionin pranveror.

Kuvendi ka ratifikuar tri marrëveshje ndërkombëtare të lidhura nga Qeveria e Kosovës: 1- Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes Kornizë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime, që rregullon aktivitetet e Bankës Evropiane për Investime në Kosovë.

2- Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim - Financimi i dytë shtesë për projektin e pastrimit të sektorit të energjisë dhe të bonifikimit të tokave - CLRP.

3-Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare „ISTISNA'A" dhe Marrëveshja për Agjencinë „ISTISNA'A" për financimin e vazhdimin të ndërtimit të rrugës Milloshevë - Mitrovicë, Rruga M2, e lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Islamike për Zhvillim.

Arsyetimin e për ratifikimin e këtyre marrëveshjeve e ka prezantuar ministri i Transportit Fehmi Mujota. Për secilën marrëveshje radhazi shefat e grupeve parlamentare kanë dhënë pajtimin e tyre dhe janë votuar me shumicë votash të deputetëve (dy të parat me votë unanime të deputetëve, kurse marrëveshja e tretë vetëm me një votë "kundër").

Në vazhdim të seancës deputetët kanë shqyrtuar për herë të parë Projektligji për fshatin Zym të Hasit, arsyetimin e të

cilit dhënë deputeti nga radhët e AAK-së, Daut Haradinaj, si propozues i këtij Projektligji. Në përfundim projektligji në fjalë është miratuar me shumicë votash të deputetëve.

Gjithashtu janë shqyrtuar për herë të dytë dhe janë miratuar përfundimisht tetë projektligje që lidhen me procesin e liberalizimit të vizave.

Raportet me rekomandime për këto projektligje (për secilin veç e veç): i ka arsyetuar nënkryetari i Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, Fatmir Xhelili. Projektligjet e miratuara janë: - Projektligji për të huajt; - Projektligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale; - Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror; - Projektligji për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit; - Projektligji për Shtetësinë e Kosovës; - Projektligji për Azil; - Projektligji për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, si dhe Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-058.

Deputetët e kanë shqyrtuar dhe miratuar edhe Projektligjin për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë, të cilin e ka prezantuar nismëtarja për këtë projektligj, deputetja, Alma Lama.

Në përfundim të seancës, duke i falënderuar për punën dhe angazhimin e tyre, kryeparlamentari Krasniqi ka dhënë një rezymë të punës së Kuvendit në sesionin pranveror, duke specifikuar 33 mbledhje të Kryesisë, 105 vendime dhe 57 përfundime të këtij organi. Ai ka pohuar se Kuvendi ka mbajtur 43 mbledhje plenare; ka proceduar 51 projektligje, ka miratuar 49 sosh, duke përmendur se 11 projektligje gjenden në shqyrtim të parë dhe 10 projektligje që i janë kthyer Qeverisë për ripunim. Janë miratuar, ndërkaq, 20 rezoluta, deklarata dhe rekomandime, si dhe janë shtruar 145 pyetje parlamentare.

Diplomati i dorëhequr, Peci, raportoi në Komisionin për Punë të Jashtme



Komisioni për Punë të Jashtme i Kuvendit të Republikës së Kosovës ka organizuar më 26. 6. 2013 dëgjim me ish-ambasadorin e Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Suedisë dhe ish-shefin e Misionit të Posaçëm të Republikës së Kosovës në Beograd, z .Lulzim Peci.

Diplomati i dorëhequr, Peci, ka shpjeguar fillimisht gjithë historinë e punës së tij si ambasador rezident në Suedi dhe si ambasador jorezident në pesë shtete të tjera skandinave dhe baltike, duke theksuar me këtë rast punën e madhe dhe të lavdërueshme që ka bërë për krijimin e kanaleve kredibile për komunikim me ministrinë e jashtme dhe dikasteret e tjera qeveritare të vendeve pranuese, por edhe me Parlamentin e Suedisë.

Ai ka përmendur vizitat që ka iniciuar dhe organizuar për kryeministrin Thaçi dhe për disa ministra e zëvendësministra të Qeverisë së Kosovës në Suedi e vende të tjera përreth.

Peci ka theksuar, ndërkaq, se puna e tij ka qenë e vlerësuar, prandaj edhe ministri i Jashtëm, Hoxhaj e ka lutur, këtu e gjashtë muaj më parë që, si njëri ndër ambasadorët më të suksesshëm të Kosovës, ta pranojë detyrën e shefit të

Misionit të Posaçëm të Republikës së Kosovës në Beograd, që i është përgjigjur pozitivisht.

Ai pastaj e ka shpjeguar gjithë ecurinë e përfundimit të detyrës së ambasadorit në Stokholm (më 13 qershor), dekretimin nga presidentja Jahjaga për detyrën e re në Beograd, ka shpjeguar detajisht gjithë itinerarin e udhëtimit në Beograd (më 17 qershor), vendosjen në zyrën e tij në kuadër të Zyrës së Misionit të BE-së atje, si dhe për rrugën e kthimit në të njëjtën ditë, kur edhe i ka raportuar ministrit Hoxhaj.

Peci ka pohuar se nga kabineti i kryeministrit Thaçi i ishte sugjeruar që të jepte deklarata për mediat e shkruara dhe elektronike në Beograd, që edhe e kishte bërë.

Ai pohon se në të njëjtën mbrëmje, me një mikun e tij, kishte dalë për të pirë një kafe, ku në një lokal ishte takuar , rastësisht, kryeministrin Thaçi, i cili shoqërohej nga tre ministra resorësh. Kritika gojore e Kryeministrit Thaçi për deklaratat publike të diplomatit të sapoemëruar në kryeqytetin serb, Peci thotë se kanë qenë shkak për dorëheqjen nga posti i shefit të Zyrës ndërlidhëse të Kosovës në Beograd.

“Pas kritikave të kryeministrit për deklaratat e mia publike lidhur me marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, më nuk kam qenë i sigurt se në çfarë ambienti politik të Kosovës po veprojm”, ka deklaruar Peci para anëtarëve të komisionit. Kryetari i Komisionit Albin Kurti i ka shtruar pyetje të shumta diplomatit të dorëhequr, Lulzim Peci, për anën ligjore

të emërimit të tij në detyrën me shumë emërtime nga prizmi i Kosovës, i Beogradit, apo i Brukselit, pastaj e ka pyetur nëse ka marrë rekomandime me shkrim apo me gojë për detyrën në Beograd, si dhe nëse shkaktar i dorëheqjes ka qenë kritika, fyerja eventuale, apo ndonjë veprim tjetër i kryeministrit.



Peci e ka pranuar se detyrën e ka marrë konform Marrëveshjes për Aranzhmanet Ndërlidhëse (të arritur bë bisedim et e Brukselit) dhe se emërtimet për detyrën lidhen me fjalorin e përdorimit publik të këtyre qendrave. Ai ka theksuar se nuk ka pasur asnjë vërejtje në punën e tij prej diplomati deri në ditën kritike të 17 shkurtit, por ka thënë gjithashtu se nuk ka pasur kurrfarë rekomandimesh për qëndrimin që duhet mbajtur dhe për punën e tij në Beograd.

Dorëheqja dhe mënyra e bërjes publike të saj e ka dëmtuar rëndë imazhin e diplomacisë së Kosovës, ka theksuar nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti, duke tërhequr vëmendjen se gjithë kjo është zhvilluar, jo në mënyrë institucionale, por në një takim joformal, të rastësishëm, në kafene.”Si shumë rastësi për një takim joformal me pasoja të rënda”, ka ironizuar Hamiti.

Nënkryetari tjetër i Kuvendit, Petar Miletiq, ka thënë se emërimi dhe shkarkimi i diplomatëve është punë e

ekzekutivit të vendit, por është shprehur i befashuar me një pjesë të deklaratës së Ministrisë së Punëve të Jashtme, që e fajëson diplomatit Peci pse në Beograd ka folur në njërin nga gjuhët zyrtare të Kosovës (serbisht).

Në pyetjen e Emilia Rexhepit nëse veprim i z. Peci e dëmton imazhin e diplomacisë së Kosovës, raportuesi është përgjigjur se në fakt imazhin e kësaj diplomacie e ka dëmtuar më së shumti deklarata e vetë MPJ-së.

Nënkryetari i Komisionit, Enis Kervan, ndërkaq, ka theksuar se kolegët e tij do të duhej të merreshin me veprimet institucionale dhe jo me pasojat e takimeve joformale nëpër kafene.

Duke e falënderuar për pjesëmarrje dhe gatishmërinë për të raportuar para anëtarëve të Komisionit, Albin Kurti ka theksuar se për këtë çështje dhe për çështje të tjera të funksionimit të diplomacisë së Kosovës , do të thirren të raportojnë kryeministri Thaçi dhe ministri Jashtëm, Hoxhaj.

Ministri për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale takim me Komisionin për Shëndetësi...



Tërheqja nga procedura parlamentare e Projektligjit për transplantimin e organeve, projektligjet në procedurë dhe kërkesat buxhetore për sektorin e shëndetësisë, ishin disa nga temat për të cilat ministri i Shëndetësisë në Qeverinë e Kosovës, Ferid Agani, ka raportuar më 01.07.2013 në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale të Kuvendit të Kosovës, të kryesuar nga Fikrim Damka, kryetar.

Duke e arsyetuar tërheqjen e Projektligjit për transplantimin e organeve, ministri Agani vlerësoi se kjo ka ardhur pas takimeve me ekspertë të ndryshëm ndërkombëtarë. Ai shfaqti shpresën që pas krijimit të parakushteve brenda sistemit publik shëndetësor për zbatimin e të gjitha shërbimeve cilësore për transplantimin e organeve, duke marrë parasysh edhe propozim-amendamentet e komisionit funksional, gjatë vitit të ardhshëm projektligji do të silltet serish në Kuvend.

Duke u përgjigjur në interesimin e

anëtarëve të komisionit për mundësinë e tërheqjes nga procedura parlamentare edhe të Projektligjit për transplantimin e indeve dhe qelizave, ministri Agani theksoi se nuk ka asnjë indikacion për këtë dhe ofroi mbështetjen e ministrisë gjatë procesit të amendamentimit të tij nga ana e komisionit.

Ministri Agani arsyetoi edhe kërkesat për alokime buxhetore nëpër kategori të ndryshme, të cilat, sipas tij, imponohen veçanërisht nga hyrja në fuqi e Ligjit për Shëndetësinë.

Komisioni iu dha mbështetje këtyre kërkesave dhe i rekomandoi komisionit përkatës parlamentar përkrahjen e tyre.

Në këtë takim, ministri i Shëndetësi informoi komisionin edhe për masat që po ndërmerren në menaxhimin dhe vënien nën kontroll të situatës epidemiologjike nga pickimi i rriqrave, si dhe për një varg problemesh të tjera me të cilat përballet aktualisht sektori i shëndetësisë në Kosovë

Debati publik për monitorimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve



Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, më 25.06'2013 mbajti debat publik për monitorimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, të cilin e kryesoi zonjusha Jasmina Zhivkoviq, kryetare e komisionit.

Në debat, krahas anëtarëve të komisionit të lartpërmendur, morën pjesë edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Administratës Publike, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si dhe përfaqësuesit e Institucionit të Avokatit të Popullit, OSBE-së, ECMI i Kosovës dhe të Ambasadës të Zvicrës në Prishtinë.

Në këtë debat publik, kryetarja e Komisionit, zonjusha Zhivkoviq, theksoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, duke u bazuar në mandatin e vet dhe në emër të kompetencave, të cilat dalin nga fushëveprimi i punës, ka për synim, që gjatë tërë vitit të bëjë kontrollimin e zbatimit të këtij ligji në teren. Përndryshe, ajo tha se në këtë

debat publik marrin pjesë, nga gjithsej nëntë organizata qeveritare, që për fat të keq, ftesës i janë përgjigjur vetëm tri organizata qeveritare dhe po marrin pjesë në këtë debat publik.

Në vazhdim të debatit publik për shkallën e zbatimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, përfaqësuesit e institucioneve qeveritare theksuan se në krahasim me vitet e mëparshme, gjatë vitit të kaluar, ligji i përmendur më lart, sikurse në nivelin qendror, ashtu edhe në nivelin lokal, po zbatohet dhe praktikohet më shumë në teren., me përjashtim në veri të Kosovës, ku Ligji për përdorimin e gjuhëve nuk respektohet fare, sepse, pothuaj, askund nuk ka mbishkrime në gjuhën shqipe.

Në fund të debatit publik, me qëllim të përmirësimit të implementimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare, të pranishmit shfaqën mendimet e veta se do të duhej që të gjithë të angazhohen që ky ligj në tërësi dhe në të gjitha nivelet të zbatohet me përpikëri.

Komisioni për Zhvillim Ekonomik Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Privatizimi i 75 % të aksioneve të PTK-së, ishte temë e debatit të dëgjimit publik të organizuar nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, më 25.06.2013

Në fillim të debatit, kryetari i Komisionit Zenun Pajaziti, sqaroi se dëgjimi i sotëm është organizuar për t'u njoftuar nga afër me procesin e privatizimit, para se kjo temë të debatohet në mbledhje plenare të Kuvendit. Lidhur me këtë

proces, tha në vijim Pajaziti, Komisionit i është ofruar edhe Raporti i Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75 % të aksioneve të PTK-së, andaj debati i sotëm është rast i mirë për të shqyrtuar edhe atë, tha ai.



Duke folur për procesin e privatizimit të këtyre asetëve të PTK-së, ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave Besim Beqaj, fillimisht tha se procesi ka qenë në harmoni me ligjet në fuqi dhe është zhvilluar me transparencë të plotë.

"Privatizimi është bërë mbi bazën e Ligjit për ndërmarrjet publike, ndërsa para çdo vendimi është konsultuar këshilltari i transaksioneve", tha Beqaj.

Ai tutje po ashtu njoftoi se në procesin e privatizimit nuk janë përfshirë as një nga asetet fizike të PTK-së, ndërkaq,

punëtorët do të vijojnë së punuari edhe për tre vitet e ardhshme nga momenti i nënshkrimit të kontratës në mes të PTK-së dhe fituesit të ofertës- AXSOS.

Procesin, dhe privatizimin e 75 % të aksioneve të PTK-së, të favorshëm për vendin e vlerësoi edhe ministri i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Fadil Ismajli.

Pasi foli për krijimin e kushteve të ekonomisë së lirë të tregut dhe fuqizimin e sektorit privat, Ismajli tha se rruga që po ndjek Kosova është rruga të cilën e kanë trasuar të gjitha vendet e zhvilluara.

Ministri i MZHE-së, rëndësi të veçantë i kushtoi edhe përfundimit me sukses të të gjithë procesit, sepse, sipas tij, përfundimi pozitiv i këtij procesi do të vlerësohet nga investitorët dhe të interesuarit e tjerë për këtë proces. "Duhet të përpiqemi të ndërtojmë imazh pozitiv duke shfaqur përkushtimin tonë për ekonominë e lirë të tregut", tha ai.

Transparent dhe të dobishëm, privatizimin e 75 % të aksioneve të PTK-së, e vlerësoi edhe ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq.

Ai po ashtu, vlerësoi edhe kujdesin e treguar nga Qeveria për të punësuarit në PTK, që sipas tij është e arritur e madhe gjatë këtij procesi.



Ministri Rashiq, foli edhe për kujdesin që është duke treguar kjo ministri për rikualifikimin e punëtorëve të PTK-së pas skadimit të kontratave tre vjeçare në PTK. Edhe Sandra Rath, përfaqësuese e këshilltarit të transaksioneve, vlerësoi se procei i privatizimit është zhvilluar me transparencë të plotë, ndërsa nënvizoi se privatizimi i PTK-së nuk e dëmton ekonominë e vendit.

Për përfituesin e ofertës (AXSOS), Rath se është me renome ndërkombëtare. Kosova, tha në vijim ajo, nuk po e shet postën, por vetëm disa asete të saj.

Gjatë debatit, ndërkaq, deputeti Visar Ymeri (VV), kontestoi ligjshmërinë e privatizimit të PTK-së. Duke e konsideruar të jashtëligjshëm këtë proces, Ymeri vuri në dukje edhe parregullsi të tjera, të cilat nxitën reagimin e ministrit, Beqaj.

Për sa i përket ligjshmërisë, ministri Beqaj iu referua nenit katër të Ligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës të vitit 2011 dhe hedhjen poshtë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës të mocionit të ngritur nga Lëvizja Vetëvendosje për ndalimin e privatizimit të PTK-së.

Deputetët Hydajet Hyseni e Vjosa Osmani diskutojnë për Kosovën në Këshillin e Evropës



Deputetët e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani (LDK) dhe Hydajet Hyseni (PDK) morrën pjesë në punimet dy ditore të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Strasburg, 26-28 qershor.

Ata diskutuan në takimin e Komisionit për Çështje Politike dhe Demokraci lidhur me zhvillimet në Kosovë. Ndër të tjera, deputetët diskutuan për punën e Kuvendit të Kosovës dhe ligjet e miratuara në fushën e sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut, për nevojën për zgjedhje të lira e të drejta në Kosovë, për raportet me Republikën e Serbisë, problemet në veriun e vendit, lirinë e medias dhe shumë çështje të tjera.

Deputetja Vjosa Osmani, ndër të tjera, njoftoi Komisionin për miratimin e Rezolutës së Kuvendit të Kosovës, e cila i bën thirrje Këshillit të Evropës që të bëjë presion mbi Serbinë për realizimin e të drejtave dhe lirive të shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc. Ajo po ashtu theksoi nevojën për monitorim të rreptë ndërkombëtar të zgjedhjeve të ardhshme në Kosovë, në mënyrë që të parandalohet abuzimi i votës së qytetarëve dhe theksoi nevojën e prezencës sa më të madhe të Këshillit të Evropës në këtë proces.

Duke iu referuar Rezolutës së KE-së për Kosovën, ku thuhet se qytetarët e Kosovës duhet të gëzojnë të njëjtat të drejta sikur qytetarët e tjerë të Evropës, deputetja Osmani theksoi se kjo do të jetë e mundur atëherë kur Kosova të jetë anëtare e Këshillit të Evropës, që

rrjedhimisht do t' i lejonte qytetarët e Kosovës të ngrenë shkeljen e të drejtave të tyre nga institucionet publike në Kosovë dhe në Gjykatën e Strasburgut. Komisionet e APKE debatuan edhe për tema të tjera, siç janë: korrupsioni si kërcënim i sundimit të ligjit; liria e të shprehurit dhe e medias në Evropë; proceset zgjedhore në vendet anëtare të Këshillit të Evropës etj.

Deputeti Hydajet Hyseni, pasi theksoi përpjekjet e gjithanshme institucionale për përmbushjen e rekomandimeve nga Rezoluta e APKE, vuri theksin në nevojën e qasjes adekuate parimore dhe gjithëpërfshirëse të procesit të normalizimit të raporteve midis Kosovës dhe Serbisë, dhe, në këtë kontekst, potencoi domosdonë e ratifikimit dhe implementimit të marrëveshjes nga të dy vendet, dhe jo vetëm nga Kosova, fokusimin në shkaqet dhe jo në pasojat e problemit, si dhe në parandalimin e mundësisë së përdorimit të saj si bluf politik.

Duke vlerësuar rolin e pranisë ndërkombëtare në Kosovë deputetët theksuan nevojën e përsheptimit të procesit të integritimit të Kosovës në strukturat evropiane, si mënyrën më të mirë për demokratizimin dhe evropianizmin e vendit dhe gjithë rajonit.

Me vendim të organeve të Këshillit të Evropës, që nga maji i këtij viti, deputetët Hyseni e Osmani ftohen në takimet e Komisioneve të APKE, ku kanë të drejtën e fjalës, pavarësisht temës që diskutohet, por nuk kanë të drejtë vote.

Nga aktivitetet e GGD-ës

Delegacioni i GGD-ës zhvillon takime me personalitet të larta të Senatit dhe të Parlamentit në Mbretërinë e Holandës

Holanda do ta mbështesë fuqishëm Kosovën në të gjitha aspiratat e saj, e veçanërisht në aspektin e anëtarësimit në BE



Një delegacion i Grupit të Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës i përbërë nga znj. Teuta Sahatçia, znj. Alma Lama dhe znj. Donika Kadaj Bujupi, kreu një vizitë në Holandë dhe zhvilluan takime të ndryshme me përfaqësues të këtij shteti.

Në takimin me kryetarin e Senatit, z. Fred de Graaf dhe sekretarin e përgjithshëm z. Geert Jan-Hamilton, grupi i Grave Deputete, pasi shprehu falënderime për mbështetjen e dhënë në vazhdimësi, bisedoi lidhur me situatën aktuale në Kosovë duke ngritur çështje të problemeve në veri të Kosovës, të implementimit të marrëveshjes dhe sfidat e saj. Po kështu u prezantua puna e Grupit të Grave Deputete në shumë fusha, si: në ekonomi, pjesëmarrjen politike, media, etj.

Kreu i Senatit, z. Fred de Graaf, deklaroi se Holanda do ta mbështesë fuqishëm Kosovën në të gjitha aspiratat e saj, e veçanërisht në aspektin e anëtarësimit në BE. Në lidhje me procesin e liberalizimit të vizave ai u pajtua se Kosova nuk duhet të mbetet i vetmi vend në rajon, i cili nuk ka përfituar nga ky proces.

Gratë deputete të Kuvendit të Kosovës zhvilluan gjithashtu një vizitë edhe në Parlamentin e Holandës. Kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, znj. Anouchka van Miltenburg, e përshëndeti delegacionin e Kosovës, i cili mori pjesë në seancën parlamentare, duke çmuar lart punën e Grave



Deputete të Kuvendit të Kosovës, si një grup unik, i cili po përpiqet me sukses të sjellë ndryshime në shoqëri. Përfaqësueset e GGD-ës patën takime edhe me zv. kryetaren e Dhomës së përfaqësuesve, znj. Khadija Arib, me sekretaren e përgjithshme, znj. Jacqueline Biesheuvel-Vermeijden, si dhe një drekë pune me grupin e parlamentarëve nga Komisioni për Arsim, Shkencë e Kulturë.

Deputetet Vjosa Osmani dhe Jasmina Zivkovic vizitë zyrtare në SHBA



Deputetet e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani (LDK) dhe Jasmina Zivkovic (SLS) po qëndrojnë në SHBA ku po marrin pjesë në programin "Women in Public Service", i themeluar nga Departamenti Amerikan i Shtetit.

Qëllimi i programit është të bashkojë dhe fuqizojë gra në pozita udhëheqëse, nga e gjithë bota, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në institucionet publike të vendit të tyre. Gjatë kësaj vizite, ato

u takuan edhe me ish-Sekretaren amerikane të Shtetit, Hillary Clinton, si dhe me përfaqësues nga Kombet e Bashkuara, Departamenti i Shtetit, USAID, si dhe me diplomate, deputete e zyrtare të larta nga shtete të shumta të Azisë e Paqësorit, Afrikës dhe Amerikës Latine.

Në ditët në vijim ato do të takohen edhe me kongresmenë, përfaqësues të UNDP-së, Bankës Botërore, NDI dhe të organizatave të tjera.



U mbajt tryeza "Pozita e grave të komunitetit rom në Kosovë"

Grupi i Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës, në bashkëpunim me NDI-në, ka organizuar sot tryezën me temën: "Pozita e grave të komunitetit rom në Kosovë".

Deputetja Flora Brovina, e cila e udhëhoqi këtë tryezë, evokoi kujtime nga përvoja e saj, duke vlerësuar se

ndjeshmërinë për gjendjen jo të mirë të romëve në Kosovë e ka fituar gjatë punës së saj si mjeke. "Ne si shoqëri dhe si institucione, na takon që së bashku me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, të krijojmë mundësi që të përmirësohet pozita e tyre", theksoi ajo.



Deputeti Albert Kinolli tha se pozita e romëve në Kosovë është më e vështira, sepse, sipas tij, ata ballafaqohen me analfabetizëm, varfëri e papunësi. Po kështu deputetja Albulena Haxhiu dhe panelistja Shpresa Agushi, drejtore e Rrjetit të grave rome, ashkali dhe egjiptiane, theksuan se duhet bërë më shumë, sidomos në zbatimin e Strategjisë për integrimin e këtyre komuniteteve në shoqëri. Në diskutim morën pjesë edhe Bashkim Ibishi, Daut Qingallgiu,

Mimoza Gavrani etj.

Nga kjo tryezë u rekomandua që të bëhet më shumë për nxitjen e arsimimit të fëmijëve dhe të rinjve romë, të aplikohen politika afirmative me qëllim të përfshirjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe gruas në veçanti, në institucione qendrore dhe lokale, të angazhohen në parti politike, të gjenden forma për ngritjen dhe kualifikimin e këtyre komuniteteve, me qëllim të punësimit të tyre.

Rezolutë për Fuqizimin e Gruas: "Parimet e Prishtinës"

Grupi i Grave Deputete në bashkëpunim me NDI-në organizoi tryezën, në të cilin u diskutua lidhur Rezolutën për Fuqizimin e Gruas " Parimet e Prishtinës " .



Takimin e hapi kryetarja e GGD-ËS znj. Teuta Sahatçia, e cila tha se " Parimet e Prishtinës " të dala nga Samiti i gruas i organizuar nga presidentja e Republikës së Kosovës, hyn në fuqi pas shndërrimit të këtyre parimeve në një rezolutë e cila u aprovua me koncenzus të plotë nga të gjitha deputetet.

Tanimë është koha që nga kjo rezolutë nga secila pikë e saj të dalin veprimet konkrete, strategjitë dhe objektivat për realizimin e saj, ashtu siç u realizua Oda ekonomike e grave. Në takim u bisedua lidhur me inkurajimin institucioneve të ndryshme, ku kërkohet eliminimi i pengesave të ndryshëm dhe realizimi i planeve konkrete dhe me afate. U diskutua edhe për përfaqësimin politik, ekonomik, të sigurisë etj.

Znj. Suzan Novobërdali tha se në Parlament po bëhet një punë e mirë sa i përket legjislacionit, dhe ka kujdes të shtuar për përfshirjen e perspektivës gjinore.

Drejtoresha e Misionit të USAID-it në Kosovë znj. Maureen A. Shauket, tha se është me rëndësi që në Kosovë po

ndodhin për çdo ditë ndryshime, në funksion të zhvillimit të gjithmbarshëm.

Antigona Baxhaku tha se gratë në botë përfaqësojnë, jo vetëm 50% të popullsisë, por edhe 50% të potencialit intelektual, ekonomik etj, prandaj edhe duhet angazhuar që ky potencial të jetë në funksion të zhvillimit politik, demokratik, ekonomik etj.

Kurse panelistja tjetër znj. Vjollca Krasniqi e cila foli për Sigurinë e Gruas dhe qasjen e saj në drejtësi, tha: " duhet bërë më tepër për të drejtat e gruas me ligj sa i përket sigurisë së saj, të drejtës në pronë, trashëgim, dhe sidomos duhet angazhuar për luftimin e dhunës ndaj gruas " .

Linda Shala foli për nevojën e fuqizimit ekonomik të gruas, buxhetimin gjinor, si dhe krijimin e mjedisit të favorshëm për biznes.

Në diskutim morën pjesë edhe deputetet: Alma Lama, Donika Kadaj-Bujupi dhe Lirie Kajtazi, si dhe pjesëmarrëse tjera në tryezë Ilirjana Jaka, Mirlinda Kusari etj.

Tryezë

“Gratë dhe zhvillimi ekonomik”

Grupi i Grave Deputete mbajti një tryezë në Istog me temën “Gratë dhe zhvillimi ekonomik”, përkrahur nga NDI.

Fillimisht nikoqirja e tryezës deputetja znj. Donika Kadaj Bujupi pasi u shpreh mirëseardhjen të pranishmëve tha se nga pjesa dërmuese e të papunëve, 60 për qind janë gra. Sipas saj gjendja jo e mirë ekonomike sociale, sidomos e grave janë arsye që ne të punojmë më tepër

për ta përmirësuar këtë gjendje. “Nga vizitat dhe takimet e shumta ne kemi vërejtur se ekziston mundësia që kjo gjendje të përmirësohet.

Disa gra dhe burra kanë arritur të fillojnë biznese me pak buxhet, dhe ta rrisin biznesin e tyre.



Ne duhet të drejtojmë veprimtaritë në bazë të potencialit që kemi. Në Istog rreth 70 për qind e popullatës varen nga bujqësia dhe ky sektor duhet të përkrahet” tha Kadaj.

Më pas kryetarja e GGD znj. Teuta Sahatçia, tha se vetëm gjatë vitit të kaluar kanë vizituar 25 komuna duke u takuar kështu edhe me gratë e kësaj pjese. Ajo tha se këtë jemi duke e bërë me qëllim të fuqizimit të grave jo vetëm në politikë dhe në vendimmarrje, por edhe për të ndikuar në politikat zhvillimore, sidomos në projekte që ndikojnë në fuqizimin ekonomik të gruas. “Gjithashtu ne po angazhohemi që t'i inkurajojmë gratë që më mundësitë që ato kanë të mësohen të krijojnë të ardhura për vete dhe familjen.

Ne kemi kërkuar nga institucionet monetare ndërkombëtare, fonde strukturale, me anë të të cilave do të përkrahen bizneset e grave dhe po presim të kemi rezultate. Por, ajo që është me rëndësi është që ju të filloni të bëni projekte serioze të analizuara dhe punuara mirë e ne të iu ndihmojmë me politika ekonomike”, tha Sahatçia.

Ndërkaq, deputetja Lirije Kajtazi duke folur për rëndësinë e shkollave profesionale tha se këto shkolla duhet të kenë rol më të madh dhe të jenë më tërheqëse dhe të jenë kompatible me tregun e punës dhe të krijojnë teknikë dhe profesionistë të mirë. Po ashtu, theksoi Kajtazi se edhe në Universitete duhet përshtatur kurrikulat me kahet e zhvillimit ekonomik.

Në fund të takimit u morën këto rekomandime:

1. Përkrahje me ligj e afarizmit të grave dhe të hartohen politika që fuqizojnë ekonomikisht gratë dhe të favorizojnë iniciativat e grave në biznes.
2. Në universitete të zhvillohen kurrikula në favor të politikave gjinore në veçanti politikave që përgatisin gratë për veprimtari ekonomike.
3. Të bëhen politika ekonomike dhe fiskale (si kredi me kushte të favorshme, tatime me norma të ulëta etj.), si dhe të subvencionohen aktivitete biznesore të grave në sektorë të ndryshëm.
4. Të shikohet mundësia e shfrytëzimit të fondeve strukturale për gratë në afarizëm,
5. Të organizohen e seminare, trajnime apo specializime të ndryshme, me qëllim të rritjes së kapaciteteve të grave për afarizëm
6. Të rritet bashkëpunimi i grupit të Grave Deputete me Grupet e grave në komuna dhe gratë nga shoqëria civile, parti politike dhe grave në përgjithësi në bordet e ndërmarrjeve publike.
7. Të nxitet absorbimi i graveve nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare, si në agrobiznes dhe veprimtari të tjera ekonomike.
8. Të organizohen ekspozita, panaire, publikime dhe forma të promovimit të veprimtarive afariste të grave.
9. Të bëjmë një fushatë, me qëllim të promovimit dhe konsumimit të produkteve vendore me moton: “Duaje tënden”.

Diplomacia Parlamentare

Kryeparlamentari Krasniqi priti misionarin e ringjalljes kombëtare, Branko Manojlovski



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës dr. Jakup Krasniqi, priti misionarin e ringjalljes kombëtare ndër shqiptarët ortodoks në Maqedoni, Branko Manojlovski, të cilin e ka përgëzuar për punën e madhe dhe të mundimshme që është duke e bërë për vetëdijesimin kombëtar të një numri të madh të shqiptarëve ortodoks në Maqedoni, të cilët, në kohën e socializmit jugosllavë, kanë pësuar goditje të rënda të asimilimit kombëtar.

Misionari Branko Manojlovski, me origjinë nga Reka e Epërme (që përfshinë 18 fshatra në rrethinat e Dibrës), i cili tash e 40 vjet jeton dhe punon në SHBA, por një pjesë të mirë të kohës e kalon në vendlindjen e tij, ka rrëfyer fakte pikëlluese për fatin e rreth 300 mijë shqiptarëve ortodoks në Maqedoni, ringjalljes kombëtarëve të të cilëve ua ka

kushtuar jetën e tij prej misionari.

Ai është shprehur optimist për suksesin e misionit të tij të vështirë: "Shqiptarët ortodoks në Maqedoni po u kthehen rrënjëve. Dua që fëmijët tanë dhe fëmijët e fëmijëve tanë ta dinë se vijnë nga etër e gjyshër shqiptarë, e ta kuptojnë se gjaku ujë nuk bëhet", është shprehur veprimtari nga Reka e Epërme, duke përkujtuar rilindësin e madh shqiptar të asaj treve, Josif Bageri. Jam shumë i kënaqur që ndodhem në Kosovën e lirë, duke i uruar popullit shqiptar të Kosovës suksese edhe më të mëdha në të ardhmen, e duke qenë i bindur se shteti i pavarur i Kosovës duhet të bëjë më shumë për bashkëkombësit tanë kudo që janë." Të punojmë shumë dhe drejtë për ardhmërinë e ndritur të kombit tonë", ka uruar Manojlovski.

Kryekuvendari Krasniqi priti ambasadorin e Maqedonisë, z. Stojan Karajanov



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti në një takim lamtumirës, ambasadorin e Maqedonisë, z. Stojan Karajanov, i cili e përfundon mandatin e tij në Kosovë. Me këtë rast, ambasadori u falënderua për pritjen, duke shprehur njëkohësisht edhe kënaqësinë për bashkëpunimin që po zhvillohet ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës, duke e ilustruar këtë edhe më të dhënë se ndërmjet këtyre dy shteteve janë nënshkruar 27 marrëveshje nga lëmenj të ndryshëm shoqëroro-ekonomik.

Kreu i legjislavit të vendit, z. Krasniqi, e falënderoi ambasadorin Stojan Karajanov për kontributin që ka dhënë në lëmin e bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve. Ai vlerësoi të arriturat në bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe Maqedonisë, duke shprehur gatishmërinë për avancim të mëtejshëm të marrëdhënieve në mes dy vendeve.

Bashkëbiseduesit ishin të një mendimi se është punuar shumë në thellimin e bashkëpunimit të dyanshëm, duke u angazhuar që ai në të ardhmen të avancohet edhe më.

Kryekuvendari Krasniqi priti ambasadorin jorezident të Kuvajtit për Kosovën, z. Najeeb Al-Bader



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti në një takim kurtoazie ambasadorin jorezident të Kuvajtit për Kosovën, z. Najeeb Al-Bader. Pasi u falënderua për pritjen, z. Najeeb Al-Bader, vlerësoi lart bashkëpunimin ndërmjet Kuvajtit dhe Kosovës, i cili është gjithnjë në rritje. Ai u shpreh i impresionuar me arritjet që po shënon Kosova në të gjithë lëmenjtë. Në vijim ambasadori i Kuvajtit foli edhe për nevojën e shtimit të investimeve nga ana e Kuvajtit në Kosovë.

Kryekuvendari Krasniqi në fjalën e tij theksoi se ndërmjet Kosovës dhe Kuvajtit janë krijuar baza të mira për forcimin e marrëdhënieve dypalëshe. Ai i bëri një espoze punës së Kuvendit të Kosovës në lëmin e legjislacionit, duke theksuar se me plotësimin e ligjeve krijohen mundësi të mëdha për investime të gjera në Kosovë.

Ambasadorja e Kanadasë , jo rezidente për Kosovën, znj. Louse LaRocruie: - Kompanitë Kanadeze janë të interesuara për investime në minierat e Kosovës



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti në një takim lamtumirës, ambasadorin e Maqedonisë, z. Stojan Karajanov, i cili e përfundon mandatin e tij në Kosovë. Me këtë rast, ambasadori u falënderua për pritjen, duke shprehur njëkohësisht edhe kënaqësinë për bashkëpunimin që po zhvillohet ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës, duke e ilustruar këtë edhe më të dhënë se ndërmjet këtyre dy shteteve janë nënshkruar 27 marrëveshje nga lëmenj të ndryshëm shoqëroro-ekonomik.

Kreu i legjislacionit të vendit, z. Krasniqi, e falënderoi ambasadorin Stojan Karajanov për kontributin që ka dhënë në lëmin e bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve. Ai vlerësoi të arriturat në bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe Maqedonisë, duke shprehur gatishmërinë për avancim të mëtejshëm të marrëdhënieve në mes dy vendeve.

Bashkëbiseduesit ishin të një mendimi se është punuar shumë në thellimin e bashkëpunimit të dyanshëm, duke u angazhuar që ai në të ardhmen të avancohet edhe më.

Kryeparlamentari Krasniqi priti Komisaren e Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Navi Pillay

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, ka pritur në takim Komisarën e Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Navi Pillay, me të cilën ka biseduar për gjendjen në Kosovë në aspektin e të drejtave të njeriut, të komuniteteve pakicë e të barazisë gjinore.



Kryetari Krasniqi e njoftoi Komisarën Pillay me zhvillimet e gjithmbarshme në Kosovë. Ai potencoi të arriturat e vendit, por identifikoi edhe sfidat me të cilat Kosova përballlet.

Mosqenien e Kosovës anëtar i OKB-së dhe mosnjohjen e pavarësisë nga të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian, kreu i Kuvendit i konsideroi si pengesat dhe sfidat kryesore që Kosova ka në aspektin e jashtëm. Sfida kryesore të brendshme, z. Krasniqi konsideroi sundimin e rendit e të ligjit, zhvillimin ekonomik dhe uljen e papunësisë.

Në vijim, kryeparlamentari Krasniqi theksoi bazën kushtetuese dhe ligjore që Kosova ka krijuar për garantimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Ai u ndal te Kapitulli II i Kushtetutës së Kosovës, i cili përcakton këto të drejta, ndërsa renditi edhe një varg ligjesh të kësaj fryme që Kuvendi ka miratuar gjatë viteve.

Kreu i legjislativit e njoftoi komisarën e OKB-së edhe për përfaqësimin e komuniteteve pakicë në Kuvend dhe në të gjithë trupat e tij, për përfaqësimin gjinor, për transparencën e Kuvendit dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile.

Komisarja e Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Navi Pillay, nga ana e saj, e përgëzoi kryetarin Krasniqi për punën që Kuvendi ka bërë në nxjerrjen e legjislacionit përkitazi me të drejtat e njeriut, për përfaqësimin e komuniteteve dhe atë gjinor.

Ajo shtroi nevojën e përgatitjes së një raporti për të arriturat, por edhe për nevojat dhe ndihmën që i duhet Kosovës në këtë drejtim.

Pyetjet pa përgjigje

Deputetja Albana Fetoshi (VV)

Për zv.kryeministrin z. Hajredin Kuçi

53 punëtorë të kompanisë "Marketingu" të cilët u larguan dhunshëm gjatë viteve të 90-ta nga objekti I tyre që atëhere njihej si Banka e Ljubjanës" dhe tash nuk mund ta shfrytëzojnë atë objekt. Hapësirat e këtij objekti u shfrytëzuan padrejtësisht nga misioni i OSBE-së. Për më tepër ky subject ia paguante qeranë ndërmarjeve të Serbisë. Në vitin 2010 ky objekt I është dhënë në mënyrë të paligjshme Qeverisë së Kosovës dhe sot në zyrat e punëtorëve të "Marketingut" janë vendosur Prokuroria dhe KQZ-ja.

Përse hapësirat e uzurpuara në mënyrë të paligjshme nuk po u kthehen punëtorëve të kompanisë "Marketingu"

Deputetja Alma Lama

Për zv.kryeministrin e Kosovës z. Hajredin Kuçi

1- Mediat kanë raportuar se në gjykatat e Kosovës nuk respektohet ligji për përdorimin e simboleve zyrtare. Gjykata të ndryshme në Kosovë nuk e përdorin fare logon e Republikës së Kosovës në dokumentet e tyre, përfshirë edhe aktvendimet gjyqësore. Kjo praktikë i bën shumë jo serioze ato gjykata dhe gjyqtarë që veprojnë në këtë mënyrë dhe nga ana tjetër shkelje të ligjit për respektimin e simboleve zyrtare.

A është në dijeni Ministria e Drejtësisë për këtë shkelje të ligjit? A është e vërtetë se një urdhë me gojë për të mos u përdurur logot zyrtare , është dhënë nga Gjykata supreme dhe cila është logjika pas këtij urdhëri?

2- Për Kryeministrin e Kosovës z. Hashim Thaçi

Në bazë të nenit 95 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pika 6 thuhet; - "Anëtarët e qeverisë pas zgjedhjes , japin betimin para Kuvendit. Teksti I betimit rregullohet me ligj. Megjithëse Kushtetuta ka hyrë në fuqi më 15 Qershor 2008, deri tani qeveria e Kosovës dhe Kuvendi nuk ka miratuar ndonjë ligj, në lidhje me betimin e zyrtarëve qeveritarë, ashtu sikurse ende nuk është miratuar një ligj për qeverinë, I cili do të përcaktonte mënyrën e funksionimit të qeverisë, numrin e ministrave etj. .

Cili është dokumenti mbi të cilin janë betuar ministrant e Kosovës , po zv/ministrant. Çfarë dokumenti nënshkruajnë ata në lidhje me besnikërinë që duhet të tregojnë ndaj shtetit të Kosovës?

Deputeti Agim Kuleta (Lëvizja për Bashkim)

Për zv. Kryeministren Edita Tahiri

Lidhur me negociatat me Serbinë për kodin telefonik të Kosovës.

Cila është arsyeja që ju negocioni me Serbinë për Kodin telefonik të Kosovës kur dihet që ky veprim përbën shkelje të Rezolutës së kuvendit të Kosovës nr. 04-R-07 dhe shpërfillje të Memorandumit të Bashkëpunimit në fushën e telekomunikacionit midis qeverisë së Republikës së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë?

Deputeti Halit Krasniqi (PDK)

Për ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Blerand Stavileci

Në këtë decade, nga ethet hemoragjike kanë vdekur 33 qytetarë të vendit tone. Vetëm këtë muaj, kanë vdekur pesë qytetarë. Në rrezikjanë edhe të tjerë. Pasiguria dhe ankthi i qytetarëve të zones së rrezikshme të komunave me epiqendër Malishevën, është e papërshkrueshme. Hija e vdekjes është shoqëruese në përditshmërinë e kësaj zone! Mendimet e ekspertëve ngarkojnë me përgjegjësi edhe ministrinë tuaj. Masat që janë marrë deri tani nga institucionet e shtetit nuk janë të mjaftueshme.

Çka duhet të bëni në dikasterin tuaj për të parandaluar vdekjet nga ethet hemoragjike?

Deputetja Kimete Bytyçi (LDK)

Për Kryeministrin e Kosovës z. Hashim Thaçi

Pronarët e pronave të zonave të Pejës, Istogut dhe Deçanit kanë shfaqur pakënaqësitë e tyre lidhur me pamundësinë e shfrytëzimit të pronave të tyre në zonën kufitare me Republikën e Malit të Zi.

A ka marrë ndonjë veprim Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me arritjen e ndonjë marrëveshjeje me qeverinë e Malit të Zi për tejkalimin e kësaj gjendjeje?

A mund të na informoni për veprimet tuaja, nëse janë marrë, apo cilat do të ndërmeren, nëse nuk janë ndërmarrë, për tejkalimin e kësaj situate?

Deputetja Justina Shiroka, Pula (PDK)

Për ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, z. Dardan Gashi

Shkollimi profesional është njëra prej pikave më të dobta të sistemit arsimor në Kosovë. Në Fakultetin e Bujqësisë, thuhet se ka një numër të vogël të maturantëve të interesuar për studime dhe numër të vogël të atyre që vijojnë studimet në lëmin e bujqësisë.

1- Duke pasur parasysh vështirësitë që sjell niveli i arsimimit në fushën e bujqësisë, ju si institucion, si i keni të organizuara shërbimet këshillimore dhe sa janë efektive këto shërbime?

Për ministrin e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Blerand Stavileci.

Spektori i bujqësisë ka qenë njëri prej sektorëve në fokus të madh edhe për donatorët, të cilët kryesisht kanë ndihmuar me asistencë teknike, kanë përgatitur sektorin për absorbim të investimeve më të mëdha.

2- Sa janë investimet e përgjithshme të donatorëve, si dhe a ka filluar të ndryshojë forma e përkrahjes, apo akoma vazhdon të jetë në forma të asistencës teknike?

Deputetja Albulena Haxhiu (VV)

Për zv. Kryeministren Edita Tahiri

Në vazhdimësi ju kemi dëgjuar të thoni se negociatat me Serbinë nuk do të vijnë deri tek ndryshimi strukturor i sistemit të drejtësisë dhe rendi kushtetues – ligjor I shtetit tone, tash së fundi si rezultat I këtyre negociatave politike është arritur një marrëveshje dhe shihet qartë se përmbajtja e saj ka impact juridiko – kushtetues!

Për më tepër je keni praktikuar të merrni me vetet edhe drejtuesit më të lartë që përfaqësojnë drejtësinë dhe institucionet e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës.

Kush i detyroi përfaqësuesit e institucioneve të pavarura që të marrin pjesë në negociata me Serbinë dhe çfarë baze ligjore?

Për zv.kryeministrin e Kosovës z. Hajredin Kuçi

Enver Peci , kryesues I KGJK-së në një deklaram public tha se: -“ Duhet të sqarohet ende për shkak se flitet edhe për një division të apelit të kësaj gjykate”. Ekzistenca e e një paneli shtesë në kuader të Gjykatës së Apelit nuk parashihet me ligjin për gjykatat I cili rregullon funksionimin e kësaj gjykate. “Me ligjin e gjykatave është paraparë vetëm një Gjykatë e Apelit në gjithë territorin e Kosovës” thotë Peci. Ligji i ka të përcaktuara pesë departamentet

1 - Z. zv.kryeministër dhe minister i Drejtësisë; ju thatë se me vete në delegacion kishit kryetarin e Këshillit Gjyqësor dhe Prokurial. Sipas jush ata nuk i kishin shprehur këto shqetësime. Meqë pamë se z. Enver Peci ndan të njëjtin shqetësim.

A mund të na thoni se a e shkel pika 10 e marrëveshjes ligjin për gjykata dhe a e cënon sistemin tonë të Drejtësisë?

2 – Në planin e zbatimit të marrëveshjes Kosovë-Serbi, në pikën 1 të planit përveç të tjerash thuhet;- deri në mes të qershorit të dyja palët do të kenë miratuar të gjitha ndryshimet e domosdoshme ligjore të kërkuara për zbatimin e “Marrëveshjes së pare”, përfshirë këtu edhe ligjin për Amnisti.

Cilat kategori të dënuarëve do të përfshijë Ligji për Amnisti, në lirimin prej mbajtjes së dënimit apo ndjekjes penale? A do të amnistohen vetëm serbët për vepra për ndjekje penale?

Për Kryeministrin z. Hashim Thaçi

Nenad Gjuriç u emërua komandant policie për rajonin e veriut ende pa u themeluar ky rajon si i tillë dhe ende pa u ratifikuar marrëveshja në Kuvendin e Kosovës. Në një intervistë për Kosova press, të dates 9 korrik, ministri i Brendshëm, z. Bajram Rexhepi ka deklaruar, po citoj;- “... emri I I tij për pozitën e komandantit rajonal në veri ka dalënga dialogu midis dy kryeministrave Hashim Thaçi dhe Ivica Daçiç...”

Kush e propozoi i pari Nenad Gjuriçin për komandant policie, Ju apo kryeministri i Serbisë Ivica Daçiç?

Deputeti Danush Ademi (PDAK)

Për Ministrin e Punësimit dhe mirëqenies Sociale z. Nenad Rasiç

Ndryshimi dhe plotësimi i ligjit të skemës sociale, lidhur me nenin 4, paragrafi 4.5

Si ka mundësi të punohet me një rekomandim shtesë dhe të sillni për votim në Kuvend duke respektuar të gjitha procedurat ligjore që të përmirësohet ky nen dhe të rikthehet sikur ka qenë në gjendjen e mëparshme?

Deputetja Albana Fetoshi (VV)

Për zv.kryeministrin z. Hajredin Kuçi

53 punëtorë të kompanisë "Marketingu" të cilët u larguan dhunshëm gjatë viteve të 90-ta nga objekti I tyre që atëhere njihej si Banka e Ljubjanës" dhe tash nuk mund ta shfrytëzojnë atë objekt. Hapësirat e këtij objekti u shfrytëzuan padrejtësisht nga misioni i OSBE-së. Për më tepër ky subject ia paguante qeranë ndërmarjeve të Serbisë. Në vitin 2010 ky objekt I është dhënë në mënyrë të paligjshme Qeverisë së Kosovës dhe sot në zyrat e punëtorëve të "Marketingut" janë vendosur Prokuroria dhe KQZ-ja.

Përse hapsirat e uzurpuara në mënyrë të paligjshme nuk po u kthehen punëtorëve të kompanisë "Marketingu"

Deputeti Liburn Aliu (VV)

Për zv. Kryeministrin z. Hajredin Kuçi

1 - Në samitin e Ohrit nuk u ftua presidentja e Kosovës, po ashtu nga kryetari I Kuvendit na erdhi një reagim ku flitet për mosftesë të Kuvendit të Kosovës në Konferencën e 10-të të kryetarëve të Parlamenteve të vendeve të Procesit të Bashkëpunimit në Evropën Juglindore, e kjo nga ana e kuvendit të Maqedonisë. Jun ë këtë Kuvend keni këmbëngulur se Kosova pas vendosjes së fusnotës mbi emrin e saj, e cila do të shkrihej, siç thoni jus i fjollë bore, do të ishte e pranishme në të gjitha aktivitetet ndërkombëtare e sidomos ato rajonale pa asnjë pengesë apo kusht. Për momentin për sa kemi vënë re vendi ku përdoret më së shumti fusnota e ku nuk ka të bëjë me takime rajonale , është dokumentacioni që I drejtohet Kosovës nga BE.

Z. zëvendëskryeministër a mund të thoni për çfarë shërbeu fusnota dhe si mendoni ta zgjidhni këtë situatë?

2 – Ju keni thënë se Kosova së shpejti do të ketë kodin telefonik të veçantë. Dhe keni permendur se ITU do t'ia ndajë Kosovës Kodin Shtetëror që i ka takuar edhe kur ka qenë njesi federale e Jugosllavisë. Ju keni thënë se prisni që kodi 383 ose 384 do ti jepet Kosovës së shpejti.

Tashmë janë duke u zhvilluar bisedimet me Serbinë për telekomunikacionin.

Çfarë keni bërë plan të jepni në këmbim të kodit zoti zv. Kryeministër? Kodi që do ti kërkonte ITU do të jetë I Kosovës apo i Serbisë për Kosovën?

Deputetja Albana Gashi (VV)

Për Kryeministrin z. Hashim Thaçi

Z. Kryeministër më 21 shkurt të këtij viti, Kuvendi I Kosovës ka mbajtur një debat parlamentar dhe ka miratuar një mocion në lidhje me qindra punëtorë të fabrikës së tubave të çelikut në Ferizaj. Mocioni thotë se qeveria e Republikës së Kosovës dhe AKP-ja dhe organet e tjera kompetente ta bëjnë ekzekutimin në afat katërmujor të aktgjyqimeve kompetente për pagat e papaguara të punëtorëve të fabrikës së Tubave të Çelikut në Ferizaj.

Më 21 qershor të po këtij viti bëhen katër muaj z. Kryeministër nga miratimi i këtij mocioni dhe ne nuk dimë asnjë informatë në lidhje me këtë dhe punëtorët po i vazhdojnë protestat e tyre. A mund të na tregoni se deri ku ka ecur procesi?

Deputetja Vjollca Krasniqi (LDK)

Për Ministrin e Kulturës Rinisë dhe Sportit z. Memli Krasniqi

Më 21 shkurt 2013 Kuvendi debatoi për gjendjen e sportit në Kosovë dhe pas debatit nxori disa rekomandime. Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit obligohet që në afat sa më të shkurtër kohor të përgatisë një numër projektligjesh si;- Projekt-ligji për sponsorizim, - Projektligji për objektet sportive dhe menaxhimi i tyre, si dhe - Projekt-ligji kundër huliganizmit dhe dukurive të tjera negative në sport.

1- Pas votimit të këtyre rekomandimeve çfarë hapash ka ndër marrë Ministria që udhëhiqni ju për hartimin e këtyre projekt-ligjeve të lartë përmendura?

2- A keni filluar të hartoni ndonjë strategji për masivizimin e sportit? Nëse keni ndër marrë ndonjë hap deri ku keni arritur?



Liqeni Batllavë



Mali i Sharrit



Histori, Kuvendi i Kosovës

